



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 24.10.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.171/2014 “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, të ndryshuar”.

2. Projektligji “Për një ndryshim dhe një shtesë në ligjin nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar”.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Elena Xhina dhe Xhemal Qefalia

Mungojnë:

Enkelejd Alibeaj, Klotilda Bushka, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Astrit Veliaj dhe Tom Doshi.

Të ftuar:

Niko Peleshi – Ministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Lorena Goxhobelli - Këshilltare ligjore e ministrit

Irfani Tarelli - Drejtor i Përgjithshëm i Politikave të Bujqësisë.

Majlinda Bozgo- Përgjegjëse në Sekretariatit Teknik në Komisionin Qeveritar të Tokës

Toni Gogu - Zëvendësministër i Drejtësisë

Artan Syziu - Përgjegjës Sektori në Drejtorinë e Hartimit të Legjislacionit

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme. Kuorumi është i pranishëm për të vazhduar me dy çështjet që kemi në rendin e ditës:

Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.171/2014 “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, të ndryshuar””, si dhe projektligjin “Për një ndryshim dhe një shtesë në ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore””, të ndryshuar.

Në të dyja këto nisma komisioni ynë është komision për dhënie mendimi. I prezantova njëkohësisht, sepse të dyja nismat janë nismë e deputetit, kolegut tonë Erion Braçe, të cilin e kemi sot në komision për të bërë prezantimin e tyre.

Relator i këtyre dy projektligjeve është kolegu Bashkim Fino. Kanë konfirmuar pjesëmarrjen: zoti Niko Peleshi, ministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural së bashku me stafin që e shoqëron, zoti Toni Gogu, zëvendësministër i Drejtësisë dhe stafi i ministrisë që e shoqëron.

Zoti Braçe, mirë se keni ardhur sot në Komisionin e Ligjeve! Kemi nderin t’ju kemi prezent për dy nisma shumë të rëndësishme, që në vlerësimin tonë zgjidhin një problematikë të konsiderueshme që është krijuar me këto dy ligje.

Pa humbur kohë, po jua kaloj fjalën për të bërë një prezantim për kolegët e mi të komisionit, por që do të jetë me interes edhe për opinionin publik.

Erion Braçe - Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe për mua është shumë e rëndësishme prezenca në këtë komision për të ndarë një shqetësim të përbashkët me deputetët, kolegët që janë këtu, por mbi të gjitha edhe për të përfaqësuar një shqetësim të të gjithë deputetëve që mbulojnë përgjithësisht zona rurale në territorin e vendit.

Do të doja të theksoja që në krye të herës dy elemente shumë të rëndësishme. Në këto dy nisma bëhet fjalë vetëm për një tipologji të caktuar të tokës, bëhet fjalë për tokën që ka qenë në administrimin e ndërmarrjeve bujqësore.

Së dyti, bëhet fjalë për toka bujqësore të ndara. Nismat nuk synojnë të bëjnë rindarje të tokës, por kërkojnë të avancojë procesi i certifikimit me certifikatat e pronësisë, së kësaj toke që prej shumë vitesh është në përdorim të familjeve bujqësore në pjesë të ndryshme të territorit të vendit që kanë qenë të administruara nga ndërmarrjet bujqësore.

Pra, nuk bëhet fjalë as për rindarje të tokës dhe as për territore jashtë atyre që kanë administruar ndërmarrjet bujqësore që rregullohen me ligjin nr.7501.

Cili është shqetësimi që ka lindur? Besoj se ka shumë kolegë, që kanë të njëjtin shqetësim që kam unë në ato territore që mbuloj si deputet i Kuvendit të Shqipërisë, në zonat e tyre.

Së pari, ligji ka vendosur një kufizim për dhënien e certifikatës së pronësisë për ato familje që zotërojnë tokë në përdorim, por që janë vendosur në atë territor pas 1 gushtit të vitit 1991.

Çfarë ka ndodhur? Familjet bujqësore janë vendosur në ato territore para gushtit të vitit 1991 fizikisht, por pasaportizimin e tyre në ato territore e kanë bërë pas gushtit të vitit 1991 për shkak të situatës që ka qenë në atë periudhë, vështirësive për marrjen e dokumentacionit nëpër institucione të ndryshme në vendet ku ata kanë jetuar më parë apo në territorin ku ata duhet të paraqiteshin për të dorëzuar dokumentacionin për të marrë pasaportizimin, pastaj natyrisht iu është kthyer në një problem. Këto familje nga komisionet e ndarjes së tokës e kanë marrë tokën sipas normës që ishte përcaktuar nga ligji në përdorim, por procesi i marrjes së certifikatës së pronësisë për to ka stopuar për shkak të kufizimeve që ka vendosur ligji me këtë datë: 1 gusht i vitit 1991.

Cili është problemi i dytë? Ai ka të bëjë me familjet bujqësore që janë konsideruar tashmë, që janë zhvendosur me vendime të Këshillit të Ministrave për 1001 arsye, ku një nga arsyet themelore është ajo e ndërtimit të veprave të mëdha industriale, siç kanë qenë ato në Veri të vendit, që janë vendosur në këtë territor, iu është dhënë toka e ndarë për frymë sipas vendimit të Këshillit të Ministrave të asaj periudhe, por iu është ndaluar më tej marrja e certifikatës së pronësisë dhe tokën e kanë prej shumë vitesh thjesht dhe vetëm në përdorim. Janë zona të tëra në Myzeqe që janë në këtë situatë sot që flas. Njerëzit janë zhvendosur me vendime të Këshillit të Ministrave për këto arsye që ju thashë dhe nuk marrin dot certifikatën e pronësisë dhe kanë mbetur në fazën thjesht dhe vetëm të marrjes së tokës bujqësore.

Cila është tipologjia tjetër? Janë familje që kanë ndryshuar vendbanimin në momentin kur ka filluar të bëhet rregjistrimi i tokës në një territor të caktuar. Ka ndodhur që ajo familje bujqësore nuk ka qenë aty, ka qenë në emigrim, mund të jetë vendosur në një pjesë tjetër të territorit dhe kur është kthyer nuk ka qenë përfituese nga ky proces i regjistrimit të tokës, që më pas do t'i hape mundësinë e marrjes së tokës me certifikatën e pronësisë. Por ka ndodhur edhe që janë harruar familje për t'u regjistruar dhe figurojnë në

regjistra si familje që kanë ndryshuar vendbanimin edhe për këto familje që e kanë marrë tokën që atëherë, iu është ndarë toka dhe e kanë aktin e marrjes së tokës në përdorim.

Natyrisht, ne duam që të hiqet ky lloj kufizimi, sepse gjenden në atë territor, me dokumentacion janë aty, por në periudha të ndryshme kohore kanë ndryshuar vendbanimin e tyre.

Cila është tipologjia tjetër?

Janë punonjësit e shtetit që janë konsideruar në atë periudhë, që kanë marrë deri në 1 mijë metër katrorë tokë për frymë, e kanë lënë, e kanë braktisur atë tokë, nuk e përdorin prej kaq e kaq vjetësh dhe ajo tokë figuron sot me akt të marrjes së tokës në përdorim tek ta, pavarësisht se është djerrë dhe për të cilën ne pretendojmë se ajo tokë të mbetet me statusin juridik: pronë shtetërore, për t'u lënë e lirë, për t'u përdorur për aktivitete të tjera që janë të domosdoshme për zhvillimin më tej të gjithë prodhimit bujqësor dhe atij blegtoral në këto territore.

Përgjithësisht këto janë tipologjitë. Unë mendoj se kur të shkojmë në nene të caktuara, pa asnjë lloj diskutimi do të japim edhe sqarime të hollësishme.

E thashë dhe dua ta përsëris edhe një herë, jemi në një moment që kjo tokë është ndarë prej 20 e ca vjetësh, u është dhënë këtyre njerëzve me dokumente, me akt të marrjes së tokës në përdorim dhe për disa përkufizime që janë vendosur në ligj, për ngjarje që janë provuar se kanë ndodhur në territor, në anën tjetër për shkak edhe të kufizimeve që janë vendosur me vendime të Këshillit të Ministrave që kanë dalë në zbatim të këtyre ligjeve, u është frenuar procesi i dhënies së certifikatës së pronësisë së tyre.

Po flasim për një situatë reale, që edhe sikur dikush të çojë në mendje që ta stopojë këtu do të jetë shumë e vështirë të zgjidhet në territor në mënyrë tjetër dhe mënyra tjetër mund të jetë thjesht marrja e tokës.

Ndërkohë, në krahun tjetër, edhe mbetja në statuskuonë aktuale që këta të zotërojnë këtë pasuri, këtë tokë bujqësore, thjesht dhe vetëm me akt të marrjes së tokës në përdorim, pas asnjë lloj diskutimi që frenon zhvillimet e mëtejshme për këto familje bujqësore në këto territore dhe duhet një certifikatë pronësie për çdo gjë tjetër që ata do të duhet ta shikojnë si proces zhvillues në ekonominë e tyre bujqësore në atë territor ku janë vendosur.

Dua të theksoj edhe një herë, nuk po i japim tokë kujt, pra po marrim tokën e lirë apo tokën e dikujt tjetër dhe po ua japim këtyre njerëzve. Jo. Është tokë që u është ndarë këtyre familjeve, me përjashtim, siç ju thashë, të asaj tokë që lënë djerr për vite të tëra me radhë, nga e cila praktikisht njerëzit që e disponojnë si punonjës të shtetit të asaj periudhe,

por që banonin në fshat, pra ishin në punë shteti dhe banin në fshat e kanë lënë fare dhe kanë hequr dorë prej saj, për t'i dhënë statusin juridik që ajo ka në kartela dhe natyrisht për t'u vënë në dispozicion, për të zhvilluar edhe ato territore me ekonomi bujqësore apo blegtorale.

Kjo është në të dyja nismat.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Braçe!

Urdhëroni, zoti Peleshi, lidhur me nismën e kolegut Braçe!

Niko Peleshi – Faleminderit për ftesën!

Problematika e tokës bujqësore e plotësimit me tituj pronësie, e regjistrimit të titujve të pronësisë, e shmangies së mishmashit që shoqëron pronën në përgjithësi dhe në rastin konkret, tokën bujqësore, është shumë delikate dhe ne jemi, mbase jo ministria kryesore për ta iniciuar dhe çuar deri në fund këtë proces, sepse është një proces i hartimit të ligjeve që i takon Ministrisë së Drejtësisë, por pa dyshim që ne jemi shumë të interesuar, sepse shëndeti i këtij sektori varet së pari nga zgjidhja e çështjes së pronësisë së tokës, qoftë për sa i përket energjizimit të tregut të tokës, qiradhënies, qiramarrjes, shitjes, blerjes së tokës bujqësore apo mundësisë për të investuar dhe komercializuar bujqësinë kur ka iniciativa të krijimit të fermave të mëdha, të cilat janë të pamundura në kushtet e sotme, pikërisht për shkak të problematikës së tokës bujqësore.

Ne mirëpresim çdo nismë. Pa dyshim, kjo është një nismë konkrete e deputetit Braçe, e cila prek disa tipologji problemesh, por duhet ta them se janë disa tipologji në shportën e madhe të problematikave që shoqërojnë pronën.

Para se të fals pak më tepër për këtë dua të them që Shqipëria ka ndërmarrë disa procese transitore, por për fat të keq ka 25 vjet që nuk zgjidhen dhe nuk mund të quhen më transitore proceset që zgjasin një çerek shekulli. Këto procese që lidhen me pronën, sepse natyrisht ka edhe procese të tjera, por s'është ky vendi dhe rasti, janë procesi i kthimit dhe kompensimit të pronave, i filluar herët por ende jemi shumë larg përfundimit të këtij procesi, që është procesi i plotësimit me tituj pronësie dhe i regjistrimit të titujve të pronësisë së tokës bujqësore, është procesi i legalizimit të ndërtimeve. Duke sikur ne vrapojmë pas zgjidhjes së këtyre problemeve, por ndonjëherë e bëjmë më të madh problemin.

Që kur filloi historia e legalizimit të ndërtimeve pa leje në vitin 2004, në mos gabohem, Shqipëria ka pasur rreth 200 mijë ndërtime pa leje. Sa u hartua ligji, pastaj rishikimi i ligjit, pastaj qeveritë njëra pas tjetrës me të drejtë kanë bërë korrektime dhe

premtime të mbajtura dhe të pambajtura në rastet e shkuara në raport me këtë ligj dhe tullumbacja e këtij problemi u bë më e madhe në vend që të bëhej më e vogël.

Po kaq të rëndësishëm kemi edhe procesin e transferimit të pronave publike të pushtetit vendor, që është shumë e rëndësishme për ekonominë lokale dhe për bashkitë tona, sidomos mbas reformës territoriale administrative. Përmenda disa procese, të cilat, siç e thashë, duhet të marrin një zgjidhje, pra të përfundojnë në një moment të caktuar dhe nuk duhet të jenë të hapura nga fundi.

Për këtë arsye, me urdhër të Kryeministrit, është ngritur një grup pune, ka edhe një komitet ndërministror të tokës që drejtohet nga ministrja e Drejtësisë. Këtu kemi zëvendësministrin, i cili ka marrë përsipër të hartojë një ligj përmbledhës për të gjitha këto procese transitore dhe ky do të quhet ligji i përfundimit të proceseve transitore që lidhen me pronën.

Ku jemi deri tani? Jemi afër finishit.

Komiteti është mbledhur përsëri, po mbledhemi në mënyrë intensive. Kemi një draft të ligjit. Kishim draft të parë, i cili u plotësua me komente nga të gjithë ministrinë, kemi edhe një draft tjetër dhe duket se jemi pranë një konsensusi ministrive apo të gjithë anëtarëve të këtij komiteti dhe është parashikuar si afat fundor fundi i këtij viti.

Kështu ne kemi marrë angazhim si komitet ndërministror ta sjellim për miratim në parlamentin e Shqipërisë një ligj që i përmbledh të gjitha këto procese.

Në kuadrin e këtij procesi pa dyshim që nisma e zotit Braçe vlen. Ne e kemi shqyrtuar edhe secilën prej tipologjive, një për një, në ministri dhe kemi ndërtuar opinionin tonë, komentet tona, disa prej të cilave janë me të vërtetë të dobishme për procesin, ndonjë tjetër mbase është ezauruar me ligje të tjera, sepse nuk kemi vetëm një ligj, nuk kemi ligjin e famshëm nr.7501, por ka pasur vazhdimisht ndryshime dhe ligje të tjera që kanë tentuar t'i zgjidhin copa-copa problemet e shumta që e shoqërojnë këtë çështje, pra çështjen e pronës.

Pra, qëndrimi ynë si ministri e interesuar është se i mirëpresim, i bëjmë pjesë të procesit tonë, praktikisht i kemi bërë, sepse i kemi shqyrtuar brenda strukturave tona dhe kemi nderuar komente dhe opinione për secilin prej tyre. E fusim në diskutim në Komitetin e Tokës, në takimin e ardhshëm, i cili do të jetë pas pak ditësh dhe do të drejtohet nga ministrja e Drejtësisë dhe t'i integrojmë brenda këtij procesi. Nuk do të bënte sens për mendimin tim që, ndërkohë që ne jemi afër fundit, pra për dy muaj shpresojmë që ky ligj i ri përmbledhës i të gjithë proceseve transitore të miratohet në Kuvend, ne të miratojmë, e them jo në sensin

negativ, disa arnime të legjislacionit aktual. Për këtë arsye nuk po i marr tipologjitë njëra pas tjetrës.

Po jap edhe dy-tre informacione, meqenëse jemi edhe në komunikim me publikun. Cilat janë proceset kryesore, të cilat ne mezi presim t'i shpejtojmë dhe t'i përmbyllim? Kemi rreth 400-450 mijë AMTP të lëshuara. Gjysma e tyre janë regjistruar, ndërsa rreth 200 mijë nuk janë regjistruar. Për sa kohë që nuk janë regjistruar, do të thotë që nuk kanë marrë një tapi, shitblerja shitblerja e tokës, qiradhënia dhe qiramarrja e tokës janë të frenuara. Jo vetëm kaq, por shpeshherë ka edhe konflikte për arsye mbivendosjesh e të tjera.

Ç'është mbivendosja? Në fakt, mbivendosja nuk është një konflikt që ndodh në territor për shkak të mbivendosjes së tokës, sepse toka nuk paloset në territor, por mbivendosja vjen për shkak të palosjes së hartave, pra janë mbivendosjet në harta. Në 99 % të rasteve, sherret e fermerëve dhe të qytetarëve janë sherre për hartën. Pra, realisht, janë hartat në sherr, jo qytetarët. Për këtë arsye, në projektligjin e ri duam që, së pari të ndërtojmë një proces të regjistrimit të titujve të pronësisë, bazuar te realiteti. Si bazohemi te realiteti? Duke u bazuar te harta e fotografimit ajror, pra hartave territoriale që janë gjeneruar nga fotografimi ajror, i cili është shumë i saktë – në mos gabohem, pasaktësinë e ka 2 centimetra – dhe fatkeqësisht jo te harta e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Patundshme, e cila është e vetmja harta me forcë ligjore, por që është e pasaktë. Harta e saktë nuk ka forcë ligjore.

Ky proces synon të unifikojë hartat, përpjekje që e kemi filluar në vitin 2015, me një VKM, përmes së cilës i detyruam institucionet që t'i unifikojnë hartat, por kjo nuk është aq e thjeshtë.

Ligji, duke unifikuar ose duke vendosur nën ombrellë agjencitë përkatëse, që merren me proceset e plotësimit dhe regjistrimit të titujve të pronësisë, e bën praktikisht të mundshëm unifikimin e hartës, që të gjitha institucionet të punojnë me të njëjtën hartë dhe të hedhin pronat dhe shënimet e veta në një hartë të unifikuar. Thënë me fjalë të thjeshta, në këtë mënyrë duam t'i japim shpejtësi regjistrimit të gjysmës së AMTP-ve të paregjistruara në Shqipëri.

Janë edhe dy procese të tjera që bazohen në dy ligje, të cilat e kanë afatin deri më 31 dhjetor të këtij viti, dhe ndryshimet që propozon zoti Braçe kanë lidhje pikërisht me këto dy ligje. Janë shtyrë disa herë, në mos gabohem. Për gjashtë vjet me radhë janë shtyrë çdo gjashtë muaj. Ne duam të mos i shtyjme më ato ligje, që të skadojnë më 31 dhjetor, por proceset e filluara nga ato ligje, që kanë të bëjnë me plotësimin me tituj pronësie të atyre që e përfitojnë sipas ligjit, por që për arsye të ndryshme nuk e kanë marrë AMTP-në, si dhe të

verifikimit të ligjshmërisë së titujve të pronësisë – këto janë dy projektligjet – t’ia mbartim agjencisë së re të pronës, e cila do të punojë me ligjin e ri që kemi në proces, për përfundimin e proceseve transitorë të pronës. Pra, ky është qëndrimi në lidhje me këto dy procese.

Në përqindje, në peshë specifike nuk është ndonjë problematikë shumë e madhe, krahasuar me atë të parën, pra me regjistrimin e titujve të AMTP-ve. Janë rreth 5 % e përfituesve sipas ligjit, që nuk janë plotësuar me AMTP. U është krijuar mundësia me ligjin që skadon më 31 dhjetor. Bëhet fjalë për rreth 11 mijë kërkesa, që janë në proces për t’u plotësuar me AMTP. Parimi i ligjit të ri është: ne trajtojmë, përshpejtojmë, përmbyllim plotësimin me tituj pronësie, regjistrimin e titujve të pronësisë apo zgjidhjen e problematikave të pronësisë për ata subjekte që janë përfitues të ligjit, pra janë subjekte të ligjit 7501 dhe i ndryshimeve që ai ka pësuar. E tha edhe zoti Braçe, nuk është se krijojmë kategori të reja.

Dua ta them prapë herë, se ky është qëndrim personal, por edhe i institucionit që përfaqësoj: nuk duam të krijojmë një proces të ri të legalizimit të pushtimit të tokës bujqësore. E kundërta është e vërtetë: në ato zona ku ligji 7501 nuk ka vepruar fare, që kryesisht janë disa zona në Veri, por jo vetëm, ku toka është ndarë fshatçe, ku le të themi se ka pushtim të tokës, nuk është se ne duam të shpikim një ligj që krijon një proces legalizimi. Nga ana tjetër, përdoruesit faktikë të këtyre territoreve, të këtyre tokave, duam t’i pajisim me një dokument, i cili mund të jetë një dokument përdorimi, mund të jetë një dokument qiraje simbolike, por e rëndësishme është të pajisen me një dokument, sepse pa dokument, jo vetëm që nuk e shesin, nuk e blejnë, nuk e japin e nuk e marrin dot, por as nuk përfitojnë dot nga financime si IPARD-i apo skema kombëtare e mbështetjes financiare të bujqësisë, të cilat kërkojnë dokumentin e pronësisë, arsye për të cilën janë penalizuara shumë fermerë që nuk e kanë.

Mbase u zgjata pak dhe u duk pak e komplikuar, por i tillë është procesi, jo se e komplikova unë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Peleshi!

Ministria e Drejtësisë, një koment lidhur me nismat e kolegut Braçe.

Zoti Gogu, fjala është për ju.

Toni Gogu – Që të mos përsëris, për shkak se ministri e përshkroi shumë mirë qasjen që do të propozonim edhe ne, si Ministri e Drejtësisë, unë do të bëja vetëm një ndërhyrje formale. Absolutisht që Ministria e Drejtësisë e mirëpret propozimin. Ashtu siç e përshkroi edhe zoti Braçe, propozimi është shumë specifik, adreson një problem shumë të

rëndësishëm, por që është një pjesë e problematikës që ministri e përshkroi në detaje. Ministria e Drejtësisë shpreh mendimin se ndërhyrja duhet t'i bashkohet qasjes gjithëpërfshirëse që ka qeveria, në të cilën grupi ndërinstitucional i punës i ka përgatitur në dy projekte. Njëri është projektligji, të cilit ministri iu referua, e që është përfundimi i proceseve transitore të të gjithë pronësisë, ndërsa tjetri është ligji për kadastrën, ku janë edhe ndërhyrjet institucionale, se si do të bëhet arranjimi i ri institucional i menaxhimit të pronës. Këto të dyja do t'i paraqiten shumë shpejt Komitetit Ndërmintor, të ngritur me urdhrin e Kryeministrit. E gjithë problematika që adreson projekti që keni përpara, patjetër që do të merret në konsideratë, si nga grupi ndërinstitucional, ashtu edhe nga komiteti.

Kështu, do të preferonim që kjo zgjidhje që i jepet një problemi shumë specifik të bëhet pjesë e paketës gjithëpërfshirëse të proceseve të pronësisë.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Gogu!

Fjalën ia kalojmë relatorit të këtyre dy nismave, kolegut Bashkim Fino.

Bashkim Fino – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit zotit Braçe, i cili na jep mundësinë të zgjidhim probleme që nuk janë zgjidhur me vite të tëra. Falënderoj me vonesë drejtuesit e qeverisë, në lidhje me nismën që tashmë kanë marrë, e që na premtojnë se brenda vitit do të na i sjellin këto dy projektligje. Por ne jemi legjislatorët, ne i bëjmë ligjet, e në fund të fundit nuk mund të presim qeverinë, pavarësisht angazhimit që ju morët këtu. Çdo deputet ka të drejtë me Kushtetutë, që të marrë nisma ligjore, aq më tepër, siç e tha edhe zoti Braçe, kur ata janë deputetë të zonave që mbulojnë fermerët, të cilët për një kohë të gjatë e punojnë dhe e gëzojnë tokën, që e kanë në përdorim, por nuk e kanë të tyren, nuk e kanë me certifikatë. Kjo është absurde. Partitë politike, që viti 1991 kanë thënë që do ta zgjidhnin problemin e pronës dhe të tokës, sepse të gjithë ata që e kanë tokën në përdorim dhe e punojnë, duhet ta gëzojnë, se e kanë tokën e tyre.

Mua më vjen mirë që ministri i Drejtësisë dhe zëvendësministri janë

jam i bindur se me këto dy ligje këtu. Shyqyr që u bë nisma e Braçes dhe jemi këtu, që është ngritur grupi i punës nga qeveria, për të ardhur dy projektligjet: njëri projektligj i fundit i tranzicionit, siç tha ministri, për përfundimin e ndarjes së pronës, apo dhe ligji tjetër i kadastrës.

Jam i bindur se me këto dy ligje, ne do ta zgjidhim përfundimisht gjithë problematikën e 20 vjetëve.

Problemet që ngre zoti Braçe në ato dy projektligje janë shumë të drejta, të cilat, natyrisht, kërkojnë edhe mendimin e qeverisë. Janë probleme që kanë të bëjnë me afatin, që ligji nuk i lejon të gjithë ata që kanë ardhur pas 1 gushtit të vitit 1991, siç e tha edhe zoti Braçe. Pra, janë dy kategori dhe dy tipologji, të cilat janë vendosur para datës 1 gusht të vitit 1991. Siç e dini, në kohën e mëparshme janë bërë shumë vepra madhore, për shembull, në zonën e zotit Braçe, në ish-komunën Grabjan, me një vendim të Aleksandër Meksit, një pjesë e banorëve nga Veriu, nga Hasi dhe nga Kukësi, u shpërngulën nga shtëpitë e tyre në vitin 1994, në mos gabo, për t'u zhvendosur në fshatin Grabjan për shkak të ngritjes së hidrocentralit. Ata nuk shkuan atje me dëshirë, por shkuan në bazë të vendimi të qeverisë, ku thuhej se fshati i tyre do të përmytej dhe tokat e tyre do t'i jepeshin shtetit për të bërë një vepër madhore, siç është hidrocentrali. Të gjitha familjet nga Kukësi që u transferuan në fshatin në Grabjan shteti u dha tokë. Sot e kësaj dite ata e kanë tokën në përdorim, por nuk e kanë të tyren. Pse nuk duhet ta kenë tokën e tyre? Ata kanë qenë qytetarët më të rregullt të Republikës së Shqipërisë, të cilët kanë respektuar një vendim të qeverisë, duke dhënë shtëpitë e tyre për një vepër të madhe hidroenergjetike, dhe kanë shkuar në Grabjan, duke marrë përsëri një tokë, sipas vendimit të qeverisë. Ne mund të diskutojmë edhe se çfarë ka ndodhur më pas me shumë familje të tjera, qoftë nga Veriu apo nga Jugu, që kanë shkuar atje dhe kanë zaptuar toka, të cilat, ne kemi me një sistem të ngritur tek ALUIZNI, po i legalizojmë, ndërkohë që banorët e tjetër që janë transferuar e kanë marrë me vendim qeverie. Pse këto familje, të cilat sot janë të shumta në numër, që e kanë marrë tokën me vendim qeverie, nuk mund ta kenë sot pronën e tyre? Këto dy probleme nuk i ka vetëm zona që mbulon zoti Braçe, por unë jam i bindur se këto probleme i kanë edhe zonat e tjera.

Duke qenë se këto dy projektligje, që ka paraqitur këtu zoti Braçe, janë shumë të rëndësishëm (dua t'ju falënderoj, zoti kryetar, që keni ftuar ministrin e Bujqësisë dhe atë të Drejtësisë, pasi ne mund t'i diskutojmë edhe vetëm këto dy nisma ligjore dhe mund t'ua dërgojmë atyre me shkresë zyrtare për të marrë mendim) unë do të ngre disa pyetje, të cilat mund t'i shërbejnë grupit të punës, komitetit ndërmintor të tokës. Unë mendoj se ne jemi dakord, pasi edhe vetë dy ministratë thanë se jemi brenda kuadrit, për ta mbyllur këtë gjë.

Unë mendoj se ne nuk duhet t'i kalojmë sot në parim këto dy projektligje dhe t'i lemë të hapura për diskutim, por mund të ngremë pyetje dhe diskutime, që t'i marrin përsipër propozuesit e qeverisë, në mënyrë që në fillim të muajit nëntor të na i paraqesin sa më shpejt në parlament edhe këto dy nisma të deputetit Braçe. Të dyja këto nisma të përfundojnë në miratimin e dy ligjeve, siç e tha zëvendësministri i Drejtësisë, brenda këtij viti, sepse kanë të

bëjnë jo vetëm me nismat që ka marrë zoti Braçe, por edhe me nisma të tjera që ne mund t'i marrim për zona të caktuara. Për shembull, për çështjen e projektligjit për kalimin e tokës bujqësore ish-ndërmarrjeve bujqësore unë kam një pyetje për Ministrinë e Bujqësisë: a është bërë një vlerësim për numrin e individëve dhe familjeve që përfitojnë nga kjo nismë mbi impaktin financiar dhe social të saj? Pra, zoti Braçe në zonën e tij ka 15 familje, por mund të jenë 150 në të gjithë territorin e Shqipërisë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Këto probleme nuk gjejnë zgjidhje, por duke i miratuar në këtë projektligj do të gjejnë zgjidhje dhe zoti Braçe na shpjegoi se sa është numri në zonën e tij.

Në nenin 1 të projektligjit propozohet të hiqet shprehja "...dhe prej datës 01.10.1992 nuk kanë ndryshuar vendbanimin e tyre, sipas regjistrit të gjendjes civile". Këtu ne konstatojmë se nuk është argumentuar mënyra se si do të vërtetohet përdorimi i tokës bujqësore nga individë dhe familje nëse ky do të propozim hiqet. Pra, çfarë thotë zoti Braçe këtu? Ai thotë se duhet ta heqim këtë datë, sepse pengon ata, që kanë për të marrë tokën në përdorim. Pyetja ime është: si do të konstatohet një gjë e tillë? Si do të realizohet kjo gjë? Ne nuk duam që të kemi mbivendosje, siç tha ministri këtu, pra përplasje të familjeve të caktuara. Nëse kjo gjë do të hiqet, a mund të përfshihen si përfitues edhe individë apo familje, që kanë ndryshuar vendbanimin në një datë shumë më të vonshme? Kjo kërkon një përgjigje nga ju kur të sillni draftin për këtë punë.

Në nenin 1, pika 2, germa "iii" të ligjit aktual nr. 171/2014 parashikohet se ky ligj e shtrin fushën e zbatimit të tij edhe tek individët, të cilat e përdorin tokën për veprimtari bujqësore, por kanë mungesa në plotësimin e dokumentacionit. Me të drejtë mund të kenë mungesa, por si është zbatuar deri tani ky parashikim? Cilat raste janë përfshirë në fushën e rregullimit, sipas përcaktimit ligjor të saj, kur ju ka munguar një dokumentacion dhe nuk e kanë regjistruar. Pra, kjo gjë duhet parë.

Së fundi, duhet të marrim në konsideratë parashikimin e nenit 6 të ligjit aktual: "Procedurat e kalimit të tokës bujqësore duhet të ishin përfunduar dhe duhet të përfundojnë sipas ligjit aktual në 31.12.2018". Nëse mbani mend, ne e kemi shtyrë këtë afat dy herë dhe gjithmonë kemi thënë se ligji "Për ish-ndërmarrjet bujqësore" duhet të mbyllet më 31 dhjetor. Çfarë kërkon tani zoti Braçe? Ai thotë: "Meqenëse ky ligj nuk mund të zgjidhet deri në datën 31 dhjetor (bën mirë që thotë kështu), a mund ta shtyjmë deri më 30 qershor të vitit 2019?". Pyetja ime është: pse ne gjithmonë do të vazhdojmë të shtyjmë nene të caktuara të ligjeve? Këtë gjë duhet ta zgjidhni ju, duke sjellë dy projektligje, ku të shpreheni se duhet mbyllur

përfundimisht në këtë apo atë datë. Në qoftë se ne do të themi se e gjithë çështja e tokave bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore do të mbyllet më 30.06.2019, kjo do të thotë se duhen mbyllur dhe nuk duhet të mblidhemi më këtu për shtyrjen e datave, sepse kjo datë është shtyrë disa herë.

Çështja që kërkon zoti Braçe ka të bëjë me të gjithë reformën. Unë kam edhe pyetje të tjera për ligjin aktual, zoti kryetar, sepse është më kryesori, por janë identike me pyetjet që bëra më lart.

Pra, qëndrimi im, si relator, është se në parim jam dakord për t'i rregulluar këto dy tipologji shumë të rëndësishme, pasi ka ndodhur në praktikë që njerëzit e kanë tokën në përdorim, por nuk e kanë certifikatën e pronësisë. Ndërkohë, prej kohësh të gjitha forcat politike kanë thënë se do t'i japin certifikatat. Tani ka ardhur koha që t'i zgjidhim të gjitha problemet e tokës me këto dy nisma, që ka filluar qeveria. Unë shpresoj që të jetë kështu siç tha ministri dhe zëvendësministri, (nuk kam pse të dyshoj), që në qoftë se këto dy nisma dhe të tjera që kemi ne, si deputetë, do të vijnë brenda muajit tjetër, ne do t'i zgjidhim përfundimisht.

Unë besoj se jo vetëm këto dy tipologji, por edhe tipologji të tjera teknike që ka në ligjin e kadastratës apo në ligjin transitor të pronës duhet t'u japim zgjidhje. Pra, konkluzioni është se kjo nismë është pozitive, është një nismë shumë e mirë, e nisur paralelisht edhe nga deputetë, por edhe nga qeveria me grupe pune për këto dy projektligje, por problemi është se si do të veprojmë ne? Ne nuk jemi komisioni përgjegjës, por besoj se edhe komisioni përgjegjës, ku relator është zoti Beqaj, do të veprojë si ne, në sensin që të dyja këto nisma t'i mbajë të hapura për t'i diskutuar pa rrëzuar asnjërin. Ne mund t'i miratojmë këto dy nisma, por problemi është se kur të vijnë të dyja ligjet kryesore do t'i miratojmë në kompleksin e përgjithshëm.

Unë mendoj se duhet ta lemë të hapur diskutimin tonë dhe në qoftë se qeveria nuk do të na përgjigjet deri në fund të vitit, ne mund t'i miratojmë këto dy nisma pa asnjë problem edhe pas një muaji.

Ndërkohë, lidhur me pyetjet e bëra, dua një përgjigje zyrtare nga ministrinë, besoj javën tjetër, në mënyrë që t'ia nisim zyrtarisht komisionit përgjegjës për të dhënë mendimin përfundimtar. Unë mendoj që kjo çështje të ngelet e hapur, por jo me idenë për ta miratuar, sepse do të na vijnë projektligjet, ato janë atje brenda, prandaj le të miratojmë ato në parim dhe nen për nen, ku të inkludohen edhe këto dhe mbyllet si situatë.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Edhe unë bashkohem me mendimin tuaj, që debati në parim për këto dy nisma shumë të rëndësishme ka filluar, por jo me idenë për të mbaruar në pritje të nismës që do të sjellë qeveria.

Pyetja që unë kam është e drejtpërdrejtë për përfaqësuesit e qeverisë, grupi ndërministror i ngritur kur do t'i ketë gati të draftuara projektligjet që do t'u japin zgjidhje edhe problematikave që ka ngritur kolegu Braçe? Jo në kohën e ardhme, sepse koha e ardhme mund të jetë edhe viti tjetër, mund të jetë 2019-a ose 2020-a, prandaj dua të di nëse ky grup do ta përfundojë ndonjëherë punën që ka nisur? Nismat që ka sjellë kolegu Braçe janë ligjore, por ky është halli dhe shqetësimi i fshatit sot. Nëse flasim për zhvillimin e bujqësisë dhe të fshatit dhe të familjeve bujqësore dhe të fermerëve shqiptarë, do të duhen të zgjidhen këto problematika. A ka një *deadline* se kur e keni gati ju atë nismën tuaj që ne ta mbajmë të hapur debatin në parim për këto dy nisma dhe të mos shkojmë në miratimin e dy nismave të zotit Braçe? Ju më pas mund ta sillni kur të doni atë pjesën e madhe të zgjidhjes së problemit.

Niko Peleshi – Faleminderit, zoti kryetar!

Siç e thashë, grupi i punës dhe Komiteti Ndërministror kanë një afat që është fundi i këtij viti, pra kanë ngelur edhe 2 muaj nga skadimi i këtij afati. Si ministër i Bujqësisë jam pjesë e komitetit, por natyrisht jam po kaq i interesuar sa çdo përfaqësues i qytetarëve dhe i banorëve të fshatit për t'i miratuar sa më shpejt këto dy ndryshime. Për hir të së vërtetës, procesi ka ecur brenda afateve që kemi caktuar, nuk është se jemi larg përfundimit të projektit, madje tani kemi një draft të rishikuar për ligjin e proceseve tranzitore, i cili ka kaluar nëpër ministri, kanë ardhur komente, është plotësuar, mund t'ju them se ndahemi vetëm në një pikë, por besoj se nuk është rasti ta shtjellojmë këtu. Pra, kemi ngelur vetëm në një pikë për ta ndarë. Kemi bërë takime me Kryeministrin, i cili shpeshherë ka qenë në krye të punës dhe të këtij Komiteti, kemi marrë edhe vullnetin e fundit politik nga Kryeministri, që pothuajse e shteron edhe debatin e hapur ndërmjet nesh dhe besoj se do të jemi brenda afatit, i cili është fundi i vitit 2018.

Jam shumë dakord me konkluzionin e relatorit, zotit Fino, nisma është absolutisht pozitive, ne do ta integrojmë në procesin tonë, madje inkurajojmë çdo deputet apo qoftë edhe fermerë të interesuar që për çështje specifike të na shkruajnë, të na kontaktojnë në mënyrë që të mos lëmë asgjë jashtë këtij procesi.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Peleshi!

Zoti Çuçi, ka një pyetje.

Bledar Çuçi – Faleminderit, zoti kryetar!

Falënderoj propozuesin, zotin Braçe, sepse vërtet është një shqetësim dhe një gangrenë që na ka shoqëruar pothuajse në të gjitha zonat ku ne jemi përfaqësues, por edhe ministrin, për një paraqitje dhe një përmbledhje të problematikës së deritanishme sa i takon çështjes së tokave. Këtu doli qartë se problemin që tenton të zgjidhë ky amendim e pranon me të njëjtin dimension edhe ministria, edhe qeveria, pra këtu biem të gjithë dakord. Çështja qëndron te instrumenti dhe te koha se kur duhet ta miratojmë këtë gjë.

Zoti Braçe, e ka sjellë vetëm për problemin specifik që ai ngre, me një instrument ligjor brenda Kushtetutës dhe ligjeve, ndërsa qeveria thotë se duhen integruar edhe problemet e tjera që lindin për çështjen e tokave.

Zoti Ministër, një pyetje kam, pasi është shumë e rëndësishme!

Ju e përmendët pak, por do të doja të isha i qartë. Ju mendoni se do të bëni një ligj të ri, pra produkti do të jetë një ligj i ri i integruar, që do të çbëjë çdo gjë që ka qenë dhe do të jetë një legjislacion i integruar, që do të zgjidhë të gjitha problemet, apo do të shkoni si teknikë legjislative me amendimet e ligjeve ekzistuese? Pse e them këtë? E them këtë, sepse po të shkojmë sipas kësaj të dytës, unë do të isha të ecim me variantin e propozuar të zotit Braçe. Në qoftë se shkojmë me një ligj të integruar, jam dakord që të presim dhe ta integrojmë edhe amendimin e zotit Braçe te kjo pjesë e legjislacionit. Besoj se kjo është e rëndësishme, sepse ne më pas mund të marrim një vendim si komision për t'ua sugjeruar më pas edhe komisioneve të tjera.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Çuçi!

Zoti Peleshi, një përgjigje të shkurtër, sepse e di që do të largoheni për në mbledhjen e qeverisë.

Niko Peleshi – Ju kërkoj ndjesë, pasi kemi një takim me Kryeministrin!

Po, të dyja ligjet janë ligje të reja. Jo, nuk e zhbëjnë legjislacionin e mëparshëm, por ngrihen mbi legjislacionin e mëparshëm, pasi mund të ketë edhe ndonjë shqetësim dhe të mos hapim ndonjë panik.

Për ligji nr. 7501, fatmirësisht nuk ka asnjë parti që është kundër, ngelet ligji nr. 7501, ndërsa ligji i ri i përfundimit të proceseve tranzitore që burojnë nga ky ligj, vërtet është ligj i ri, por ngrihet mbi atë bazë, i jep shpejtësi procesit të regjistrimit të titujve që përfitojnë nga ligji nr. 7501, bën plotësime, korrektime të problematikave që kanë dalë nga zbatimi apo moszbatimi siç duhet i këtij ligji nga viti 1991 deri tani, i rregullon dhe u jep rrugën e zgjidhjes drejt regjistrimit të pronës, por nuk e prek thelbin.

Siç edhe jua thashë, parimi kryesor i këtij ligji është që ne nuk i ndryshojmë subjektet që përfitojnë nga ligji, por i mbështesim ato për të përfunduar një proces që edhe ligjet e sotme ia japin këtë drejtë, por e hallakasin nëpër nene, VKM, kontradiksione, por edhe për çështje që nuk kanë të bëjnë me ligjin, por me institucionet.

Ligji i dytë për kadastrën bën pikërisht këtë gjë, është për reformën institucionale, në fakt, nuk merret me ligjin, por me institucionet, i bashkon dhe i vendos nën një ombrellë në mënyrë që t'i japë shpejtësi procesit.

Ulsi Manja – Shumë faleminderit, zoti Peleshi, mund të largoheni!

Përfaqësuesit e Ministrisë së Bujqësisë mund të qëndrojnë.

Fjalën e ka kërkuar propozuesi, zoti Braçe.

Erion Braçe – Zoti Manja, jam shumë dakord me ato që tha relatori i komisionit, zoti Fino, për ta mbajtur këtë çështje hapur. Natyrisht, ju e dini fare mirë që ky është një proces që po shtrihet në atë shumë vite sa tani as nuk beson më njeri se do ta marrë tokën në pronësi, njerëzve po u humb durimi. Po ju jap vetëm disa shifra për të dalë te shqetësimi që unë kam. Vetëm në Bashkinë e Divjakës, sot që jemi duke folur, në pronësi nga toka e ish-ndërmarrjeve bujqësore, jo nga tokat e ndara me ligjin nr. 7501, janë 6000 hektarë që kanë kaluar në pronësi dhe më shumë sesa gjysma e tyre 3357 hektarë janë në përdorim, por 3300 hektarë në përdorim janë jashtëzakonisht shumë, sepse përfshijnë të paktën 1093 përdorues. Tani, nga këta 3357 hektarë, që janë në përdorim, sipërfaqja e tokës që implikohet në dy çështjet për të cilat ju fola, shkon në 715 hektarë për ata njerëz që kanë ardhur me vendime të Këshillit të Ministrave në këto territore dhe 1283 hektarë për ata që kanë problemin e 1 gushtit të '91-shit apo ata që kanë ndryshuar vendbanimin në periudha të caktuara, kur është bërë regjistrimi i tokës. Pra, nga 3300 hektarë, që sot janë me akt të marrjes së tokës në përdorim, 2000 hektarë i ndalon ligji për ta marrë në pronësi tokën.

Këtu vijmë te problemi që kam unë në raport me qeverinë: data 31.12.2018, kur efekti i këtyre dy ligjeve, që unë kërkoj të ndryshoj, mbaron. Prandaj, e gjej me shumë vend atë që tha edhe zoti Fino, që t'i vendosim një afat qeverisë që të vijë dhe të sjellë përgjigje për këtë, sepse më 31.12.2018 (një afat që po bëhet simbolik për kompanitë e basteve, por jo për këta që punojnë tokën), këta 2000 hektarë janë në ajër.

Pyetja ime është: çfarë do të ndodhë me këta 2000 hektarë më 31.12.2018, kur skadon edhe ligji që do t'u jepte mundësinë njerëzve të merrnin një certifikatë pronësie? Mbaron ky proces dhe ky ligj "vdes". Tani, çfarë do të ndodhë me këta njerëz? Afërmendsh,

nuk i ka ikur mendja njeriu të shkojë dhe t'i nxjerrë nga toka këta njerëz, se nuk e bën dot. Kjo mbaron këtu.

Atëherë, në qoftë se qeveria ka ndër mend të sjellë dy nisma të sajat, ku integron edhe këtë gjë, duhet ta bëjë brenda muajit nëntor, jo brenda fundit të vitit, që të hyjë në fuqi në datën 1 janar, për të rregulluar pjesën ku nuk dihet se çfarë ndodh nga 31 dhjetori në 1 janar.

Shqetësimi që kam unë lidhet me datën 31 dhjetor. Problemin, praktikisht, e kanë hasur të gjithë, e ka hasur çdo koleg që sot është deputet në një zonë rurale, e ka hasur Ministria e Bujqësisë, Ministria e Drejtësisë e të tjerë me radhë. Çështja e afatit merr shumë rëndësi, duke pasur parasysh edhe kapacitetet e limituara që kanë sot zyrat e regjistrimit të pasurive për të trajtuar një mori çështjesh.

Jua thashë, nga 6000 hektarë në pronësi, ka 3000 akte të marrjes së tokës në përdorim, që nuk janë trajtuar nga zyrat e regjistrimit të pasurive. Duhet të mendoni që do të dynden të gjithë atje dhe po flasim vetëm për tokat e ish-ndërmarrjeve bujqësore. Po ato toka që janë ndarë me 7501-shin? Sepse, në fund të fundit, këtyre njerëzve që kanë ardhur në këto territore me vendim të Këshillit të Ministrave, u është krijuar mundësia ta marrin tokën në pronësi, por “i vdes” afati më 31 dhjetor. Në qoftë se këta njerëz nuk paraqiten përpara zyrave të regjistrimit të pasurive në datën 31 dhjetor, e humbin mundësinë për ta marrë tokën në pronësi.

Por çfarë do të ndodhë në qoftë se këta njerëz e humbin mundësinë e marrjes së tokës në pronësi? Do të rrinë me një akt të marrjes së tokës në përdorim? Më vjen keq! Toka e dhënë në përdorim është gjithmonë titull shtetëror dhe nuk është kurrë titull privat. Po atëherë, do t'i lëmë në ajër këta njerëz?! Ky është shqetësimi.

Nuk kam asnjë lloj druajtjeje të them që e presim qeverinë, por jo më tutje se muaji nëntor, sepse nuk ka më sens pastaj dhe do të fusim në panik këto mijëra familje, që unë i kam në zonë, por të tjerët kanë me mijëra në të gjitha pjesët e territorit ku ka pasur ndërmarrje bujqësore. Më lejoni t'ju them se Myzeqeja zë pjesën më të madhe, për shkak se zhvillimi intensiv i bujqësisë në atë periudhë, me një sipërfaqe shumë të madhe të tokave bujqësore, i kaloi në ndërmarrje bujqësore. Kështu që jemi vërtet në një siklet shumë të madh. Janë në siklet njerëzit dhe ne që po mundohemi t'i përfaqësojmë.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Shumë faleminderit, zoti Braçe!

Kolegu dhe relatori Fino bëri një propozim konkret. Duke u bashkuar me sugjerimin e bërë nga relatori, por edhe me shpjegimet që dha Ministria e Bujqësisë, Ministria e Drejtësisë, së fundi edhe propozuesi i nismës, mendoj që debati në parim të mbetet i hapur, ndërkohë përfaqësuesit e dy ministrive të marrin me shkrim pyetjet e relatorit, si dhe të kolegut Çuçi, që të ketë një përgjigje për to.

Ndërkohë, një *memo* të hollësishme për thelbin e 2 nismave që propozon kolegu Braçe, por edhe shqetësimet që u ngritën këtu, t'ia adresojmë qeverisë, që brenda muajit nëntor të kemi zgjidhjet përkatëse. Në të kundërt, Komisioni i Ligjeve, si komision për dhënie mendimi, si dhe Komisioni i Veprimtarive Prodhuese, si komision përgjegjës, do të adresojnë nismat pavarësisht se zgjidhin një pjesë të tipologjisë së problematikave që kemi në fshat. Pastaj, qeveria, grupi ndërministror, kur të bëhet gati me 2 nismat e tjera për të zgjidhur të gjithë tipologjinë e problematikës që ka sot fshati dhe tokat bujqësore apo tokat e ish-ndërmarrjen bujqësore, le t'i sjellë.

Unë besoj se jemi dakord me të gjithë kolegët e komisionit në këtë pikë.

Erion Braçe – Zoti kryetar, unë dua një datë. Dua një datë për qeverinë, jo për vete. T'i vëmë një datë qeverisë, sepse..

Ulsi Manja – Sigurisht. Edhe ne si komision...

Erion Braçe – E dëgjova me shumë vëmendje ministrin dhe e respektoj për ato që tha, por të zgjasë një muaj debati vetëm për një pikë, më vjen keq...!

Ulsi Manja - Datën do ta lidhim me afatin ligjor të adresimit të problematikës. Problematika duhet të adresohet para datës 31.12.2018, kur mbaron efektet ligji “Për verifikimin dhe vlefshmërinë e titujve të pronësisë”. Kështu që unë ndaj...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në fund të nëntorit të kemi një...

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Në fund të nëntorit, qeveria...

Ulsi Manja – Po, zoti Fino.

Bashkim Fino - E bëra unë këtë propozim dhe kam të drejtë ta rregulloj. Meqë sot është data 24 tetor, si sot një muaj, megjithëse komisioni është mbledhur dhe është gati, të gjejnë mundësinë të na kthejnë përgjigje për këto dy nisma, në kuadrin e dy projektligjeve të reja që do të sjellin. Të gjejnë mundësinë që brenda nëntorit të vijnë në parlament. Në të kundërt, kemi të gjithë kohën e nevojshme, zoti Braçe, që gjatë dhjetorit (e kemi hapur edhe

si diskutim) të kalojmë këto dy nisma. Pastaj le t'i sjellin më vonë për të kapur datën 31 dhjetor.

Erion Braçe – Vetëm atë datë kam merak.

Bashkim Fino – Ajo është e zgjidhur.

Ulsi Manja - Shumë faleminderit, zoti Fino!

Besoj se bashkohemi me sugjerimin e relatorit dhe kolegut Fino.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe – Nëse bëhet në fund të vitit, duhet të na jepni një zgjidhje të ndërmjetme për datën 1 janar.

Ulsi Manja – Të lutem! Zgjidhjen e kemi të hapur, sepse dy nismat i kemi të hapura për diskutim dhe sipas sugjerimit që bëri edhe relatori, do të vazhdojmë me miratimin e nismave. Pra, diskutimi është i hapur në parim për të dyja nismat dhe do t'i miratojmë ato.

Shumë faleminderit, zoti Braçe, për prezencën në komision dhe për nismat që paraqitët!

Shumë faleminderit relatorit, kolegut Fino, si dhe të gjithë kolegëve!

Këtu e mbylлим mbledhjen e komisionit për ditën e sotme.

Mbledhja e radhës do t'ju njoftohet nga sekretaria e komisionit .

Faleminderit dhe ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA

